

NJOFTIM PARAPRAK

për shpallje të Thirrjes publike 01/2012 për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga komponenta e pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrese për zhvillim rural të Unionit European (IPARD Programa 2007-2013)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural i lajmërojnë të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik **se në gjysmën e dytë të muajit shkurt të vitit 2012** do të shpallet Thirrja publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga komponenta e pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrese për zhvillim rural të Unionit European (IPARD Programa për periudhën 2007-2013 "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/2009 nga data 03.07.2009).

Qëllimi i IPARD Programit 2007-2013 është përmes masave përkatëse për përkrahje të bujqësisë dhe zhvillimit rural të përmirësohet konkurrenca e prodhimit bujqësor dhe sektori bujqësor-ushqimor, përmes përpunshëmërisë së tyre me standardet e Unionit European dhe arritja e mjedisit jetësor të qëndruar dhe zhvillimi socio-ekonomik të mjediseve rurale përmes rixitjes së aktivitetit ekonomik dhe rritjen e mundësive për punësim.

Mjetet financiare nga IPARD Programa 2007-2013 në lidhje me zbatimin e Thirrjes publike nga muaji **shkurt të vitit 2012** dedikohen për masat në vijim:

Masa 101 – Investime në ekonominë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit të tyre për arritjen e standardeve të Unionit European.

Masa 103 – Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Unionit European.

Masa 302 – Diverzifikim dhe zhvillim të aktiviteteve ekonomike rurale.

Rregullat për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programa 2007-2013 udhëzojnë arritjen e kontratës paraprake të shfrytëzuesve potencial me Agjencionin për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe realizimin e investimit të lejuar në bazë të arritjes së kushteve të kontraktuara. Kontrollim në vend të ngjarjes dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kontratës e kryejnë personat e autorizuar nga Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë për udhëheqje, zbatim dhe kontrollë të IPARD dhe Unioni European.

Mënyra dhe procedura për shfrytëzimin e përkrahjes financiare nga IPARD Programa 2007-2013 janë të shënuara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga komponenta e pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrese për zhvillim rural të Unionit European

Shpallja do të zgjasë **45 ditë** nga dita e shpalljes së Thirrjes publike në shtypin ditorë.

Vërejtje: Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesave, duke përfshirë dhe Udhëzimet për shfrytëzuesit e mjeteve nga IPARD Programa 2007-2013 do të azhurohen dhe publikohen në web faqen e Agjencionit në periudhën deri në shpalljen e Thirrjes publike.

Informata më detale në lidhje llojet e investimeve që do të jenë të përkrahura, kriteret për fitimin e përkrahjes financiare, lartësia e përkrahjes sipas masave të interesuarit mund t'i marrin në:

Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

Telefoni: 02 3097-460

Faks: 02 3097-454

e-mail adresa: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

www.ipardpa.gov.mk

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujrave

Trupi për udhëheqje me IPARD

Telefoni: 02 3109-809

Faks: 02 3110-887

e-mail adresa: info@ipard.gov.mk

www.ipard.gov.mk

Agjencioni për nxitje të zhvillimit në bujqësi

Telefoni: 047 228-330

Faks: 047 228-370

www.agencija.gov.mk Çdo ditë pune prej ora 8:30 h deri 16:30 h.

Informata për përgatitjen dhe dorëzim të kërkesave, si dhe këshillat praktike për aplikim, të interesuarit prodhues bujqësorë mund t'i marrin në qendrat regjionale të Agjencionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi. (Lista e kontakteve të qendrave regjionale dhe personave kompetentë është e shpallur në web faqen e institucioneve kompetente).

